



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.278/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të znj. Kimete Gashi – Kryetare, z. Agon Ramadani – Referues, z. Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Diamanti”SH.P.K.– Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Aneks në rrjetin e ujësjellësit brenda në qytetin e Lipjanit”, me nr. të prok: 613-22-6457-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Lipjan”, më datën: 09.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Diamanti”SH.P.K.– Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Aneks në rrjetin e ujësjellësit brenda në qytetin e Lipjanit”, me nr. të prok: 613-22-6457-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Lipjan”.

II.OBLIGOHET, Autoriteti Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Aneks në rrjetin e ujësjellësit brenda në qytetin e Lipjanit”, me nr. të prok: 613-22-6457-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Lipjan” që të bëjë zgjatjen e afatit për ofertim në kuptim të nenit 53.neni 7. të LPP-se .

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Diamanti”SH.P.K.– Prishtinë, i aprovet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues: “Diamanti”SH.P.K.– Prishtinë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Diamanti”SH.P.K.– Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.07.2022 me nr. 278/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Aneks në rrjetin e ujësjellësit brenda në qytetin e Lipjanit”, me nr. të prok: 613-22-6457-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK - Lipjan”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 7 , 27 , 56 , si dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 18.9 , 26.4 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.07.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 27.07.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Diamanti”SH.P.K.–
Prishtinë,

Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - Komuna Lipjan, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për te kontratë, përkatësisht kontestohen kërkesat e kualifikimit, qe ndërlidhen me kapacitetin teknik dhe profesional -stafit dhe pajisjeve teknike.

- Kundër njoftimit për kontrate dhe kërkesave te kualifikimit, parashtruesi i ankesës përmes kërkesës për ri shqyrtim te datës 14.07.2022, ka kërkuar nga AK , qe ti modifikoi kërkesat ne mënyre qe te zgjerohet konkurrenca, megjithatë AK, përmes përgjigjes se datës 14.07.2022, ka refuzuar kërkesën si te pa bazuar, ka lenë ne fuqi njoftimin për kontrate me arsyetimin kryesor se AK - Komuna Lipjan ka korrigjuar pjesërisht kërkesat dhe me kërkesa te tilla nuk diskriminon operator ekonomik.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore (neni 113): Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se AK, ne kuadër te kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional për stafin dhe pajisje ka kërkuar (pas njoftimit mbi përmirësimin e gabimit):

A) Një inxhinier mastar apo bachelor i diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi hidroteknike, te jete i certifikuar edhe për Organizim dhe menaxhim i kantierit te ndërtimit i njëjti te jete i caktuar nga OE edhe si menaxher për këtë projekt, minimum 5 vite provoj pune pas diplomimit c). Një punëtor i certifikuar për testim te gypave sipas EN805 Ë400,

Kërkesa 3

Lista e pajisjeve teknike b) Kamion me vinç pasha bartëse max 2.5t. min 1 cope, c)Kompresor gjysme rimorkio min. 1.S.t min 1 cope, d) Bager me çekan 8-10t min 1 cope, e) luge ngarkuese 3-4 ton min 1 cope, i) Makine hidraulike për shpim horizontal min 1 cope, j) Cisterna e ujit gjysme rimorkio për testim min 1 cope.

Te njëjtat kërkesa te kualifikimit, kontestohen nga parashtuesi i ankesës, përkatësisht sipas deklaratës ne ankese ankuesi thirret ne kërkesa te publikuara ne njoftim për kontrate. Megjithatë AK. - Komuna Lipjan, përmes formularit standard - Njoftimit mbi korrigjimin e gabimit te datës 07.07.2022, ka ndryshuar disa nga kërkesat siç janë kamioni me vinç ; kompresor gjysme rimorkio; bager me çekan dhe luge ngarkuese.

Për këto pajisje AK, ka lejuar tolerance te kapacitetit, përkatësisht është përcaktuar minimumi apo maksimumi i pajisjeve. Për me tepër po ti referohemi para masës dhe para llogarisë, rezulton qe AK - Komuna Lipjan, përmes kësaj procedure te prokurimit përveç tjerash do te realizoj punë qe ndërliiden me shpimin dhe tejkalimin nga njëra ane e rrugës ne tjetrën, rrjedhimisht makina për shpim horizontal është e nevojshme, për realizim te kontratës.

Ndërsa lidhur me kërkesën për "Inxhinierin e certifikuar për organizim dhe menaxherin te kantierit te ndërtimit" dhe "'Punëtor te certifikuar për testim te gypave sipas EN805 Ë400", vlerësojmë se te njëjtat kërkesa kufizon konkurrencën dhe bien ndesh parimet dhe dispozitat ligjore për prokurim publik, Neni 7 paragrafi 6 i LPP-se Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, përcakton: Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet

përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse. Përfundimisht, bazuar në atë që u përshkrua si më lartë propozimi ynë për AK - Komuna Lipjan, është që kërkesën për “Inxhinierin e certifikuar për organizim dhe menaxhim të kantierit të ndërtimit” dhe “Punëtor të certifikuar për testim të gypave sipas EN805 Ë400”. t’i largoi nga kërkesat e kualifikimit meqë është kërkuar pajisje për testim të gypave, përkatësisht tu lejohet ofertuesve të interesuar që pajisjet e kërkuara të mund të ofrohet marrëveshje për shfrytëzim apo para kontraktim në mënyrë që të zgjerohet konkurrenca sa më e gjere për ofertuesit e interesuar dhe të cilët kanë aftësi dhe kapacitete për realizim të kontratës. - Si prove se bashku me raport gjeni kopjet:

Pjese nga para masa si dhe njoftimi mbi përmirësimin e gabimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, OE “Diamanti” sh.p.k - Prishtinë, të aprovohet si e bazuar pjesërisht, dhe të obligohet AK - Komuna Lipjan që të bëjë zgjatjen e afatit për ofertim në kuptim të nenit 53, 7, të LPP-se dhe të njoftohen ofertuesit e interesuar me ndryshimet e mundshme.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27.08.2022, me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 29.07.2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se lënda të përcjellët të paneli shqyrtues i OSHP-së, dhe nuk e ka cekur e pranon apo jo raportin e ekspertit.

Operatori Ekonomik: “Diamanti”SH.P.K.— Prishtinë, me datë: 28.08.2022, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.09.2022, pa praninë e palëve në procedurë konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,

njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashitësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Sa i përket pretendimit nga OE ankues se AK ka kërkuar të kemi edhe Inxhinierin e certifikuar për organizim dhe menaxhim të kantierit të ndërtimit” dhe “Punëtor të certifikuar për testim të gypave sipas EN805 Ë400”, paneli shqyrtues ia falë besimin raportit të ekspertizës e cila e specifikon se - AK duhet t’i largoi nga kërkesat e kualifikimit meqë është kërkuar pajisje për testim të gypave, përkatësisht tu lejohet ofertuesve të interesuar që pajisjet e kërkuara të mund të ofrohet marrëveshje për shfrytëzim apo para kontraktim në mënyrë që të zgjerohet konkurrenca sa më e gjere për ofertuesit e interesuar për këtë aktivitet.

Lidhur me pretendimin r parashtruar tek Kërkesa 3. Lista e pajisjeve teknike:

- b) Kamion me vinç pesha bartëse max 2.5t. min 1 cope,
- c)Kompresor gjysme rimorkio min. 1.S.t min 1 cope,
- d) Bager me çekan 8-10t min 1 cope,
- e) luge ngarkuese 3-4 ton min 1 cope,
- i) Makine hidraulike për shpim horizontal min 1 cope,
- j) Cisterna e ujit gjysme rimorkio për testim min 1 cope,

Paneli Shqyrtues konstaton se ky pretendim duhet të rishikohet edhe njëherë nga AK , dhe të konsultohen ekspertët e lëmisë përkatëse pastaj të listohen vetëm mjetet e punës të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e aktivitetit të prokurimit me qëllim që të zgjerohet konkurrenca sa më e gjere për ofertuesit e interesuar dhe të cilët kanë aftësi dhe kapacitete për realizim të kontratës,

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë rast sa i përket kërkesave të vendosura në Dosje të Tenderit që ndërlidhen me pretendimeve ankimore, janë në kundërshtime me nenin 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Andaj, AK duhet të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të shtyjë afatin për ofertim konform nenit 53.7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale -Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimt të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK - Lipjan”,

1x1 OE - “Diamanti”SH.P.K.– Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
znj. Kimete Gashi

